



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
Kuvendi – Skupština - Assembly

Legjislatura III

Seanca e Kuvendit të Kosovës

P- 007

Prishtinë, më 20 shkurt 2008, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

NGA SEANCA E KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 20 SHKURT 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 100 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2008, në bazë të Vendimin të Kuvendit për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe Legjislacionin e ndërlidhur me te, datë 15 shkurt 2008, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Deputetëve u është shpërndarë ky

R e n d i t e:

1. Raporti i Komisionit ad hoc lidhur me shqyrtimin e projektligjeve nga Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për privilegje dhe imunitete diplomatike,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shtetësinë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për policinë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin policor,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dokumentet e udhëtimit,

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorimin e simboleve shtetërore,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zonat e veçanta të mbrojtura,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vetëqeverisjen lokale,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kufijtë administrativ komunal.

Kryetari propozoi që të procedohet sipas këtij rendi të ditës.

1. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit ad-hoc lidhur me shqyrtimin e projektligjeve nga Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës

Kryetari i informoi deputetët se shqyrtimi i parë i projektligjeve, të paraparë me këtë rend dite, është bërë më 19 shkurt 2008 dhe në bazë të Vendimit të Kuvendit, datë 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin e dytë dhe miratimin e tyre.

Ai ftoi kryesuesin e Komisionit ad hoc ta paraqesë raportin.

Fehmi Mujota, në emër të Komisioni ad-hoc tha se në bazë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 19 shkurt 2008, Komisioni i ka shqyrtuar të gjitha projektligjet, të cilat Kuvendi i ka miratuar në lexim të parë.

Komisioni, me propozim të sponsoruesit, i rekomandon Kuvendit që Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme të tërhiqet nga shqyrtimi i dytë.

Komisioni ad-hoc, në bazë të mandatit që ka marrë nga Kuvendi, ka punuar në mënyrë intensive gjatë shqyrtimit të këtyre projektligjeve. Të gjithë anëtarët e Komisionit kanë pasur amendamente për të ndryshuar çështjet të cilat do të rregullonin më mirë jetën e qytetarëve të Kosovës.

Komisioni ka përgatitur një numër të amendamenteve, të cilat rregullojnë kryesisht çështje të natyrës teknike dhe çështje të cilat fillimisht nuk kanë qenë të rregulluara për shkak se ligjet kanë qenë të hartuara në një kohë pak më të hershme.

Kemi konstatuar se ligjet janë në përputhshmëri të plotë me Dokumentin gjithëpërfshirës të Marti Ahtisarit.

Kërkojmë nga Kuvendin që të ketë mirëkuptimin dhe t'i aprovojë ndryshimet e parapara përmes amendamenteve që i ka ofruar Komisioni.

Kryetari kërkoi nga grupet parlamentare që të deklarohen për Raportin dhe rekomandimet e Komisionit ad hoc.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së tha se mbështet raportin dhe rekomandimet e Komisionit ad hoc.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së deklaroi se mbështet amendamentet e propozuara nga Komisioni ad hoc.

Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së tha se mbështet amendamentet e Komisionit ad-hoc për shqyrtimin e ligjeve që burojnë nga Propozimi gjithëpërfshirës i Presidentit Ahtisari.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së tha se mbështet amendamentet e Komisionit ad-hoc dhe miratimin e ligjeve të propozuara.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së tha se mbështet Raportin dhe amendamentet e Komisionit ad-hoc.

Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar „7+“ deklaroi se mbështet amendamentet e propozuara nga Komisioni ad hoc dhe miratimin e të gjitha ligjeve të propozuara.

Kryetari propozoi që në tekstin e të gjitha ligjeve ku përmendet “Kosova” të thuhet: “Republika e Kosovës”.

Ai hodhi në votim rekomandimin e Komisionit ad hoc (me pëlqimin e sponsoruesit) që të tërhiqet nga shqyrtimi i dytë Projektligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----72,
Kundër-----11,
Abstenime----- 8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi rekomandimin e Komisionit ad hoc për tërheqjen e Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme nga procedura e shqyrtimit.

Pastaj, kryetari procedoi me votimin e amendamenteve, veç e veç, për secilin Projektligj.

Kuvendi miratoi këto amendamente: Amendamentin nr. 1 në Projektligjin për shtetësinë e Kosovës; Amendamentin nr. 1 dhe 2 në Projektligjin për policinë; Amendamentin nr.1 në Projektligjin për Inspektoratin e policisë; Amendamentin nr. 1 dhe 2 në Projektligjin për dokumentet e udhëtimit; Amendamentin nr. 1 në Projektligjin për simbolet shtetërore; Amendamentin nr. 1 dhe 2 në Projektligjin për zonat e veçanta të mbrojtura; Amendamentin nr. 1, 2, 3 dhe 4 në Projektligjin për vetëqeverisje lokale; Amendamentin nr. 1 dhe 2 në Projektligjin për kufijtë administrativ të komunave.

Në fund, **Kryetari** hodhi në votim Projektligjet dhe amendamentet e propozuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----87;
Kundër----- 4;
Abstenime-----9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicë votash miratoi nëntë (9) ligje nga Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 12:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale